



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:019102

Datë: 18.07.2022

Numri i dokumentit: 03239964

P. nr. 34/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.I. nga Gj., për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 313 par.2 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP/II nr. 04/22 të dt.31.01.2022, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **06.07.2022**, në prani të Prokurorit së shtetit Qazim Xharra si dhe të akuzuarit, me datën 08.07.2022 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **N.I. nga Gj., Rr...**, i lindur me... në fsh. P. K Gjakovë, nga i ati B. dhe e ëma Gj. e gjinisë M., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike – shfrytëzues i ndihmave sociale, në bashkëjetesë, atë i 6 fëmijëve, egjiptian, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal...

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

-me datë 07.12.2021 rreth orës 10:48 min, në Gjakovë në Rr.“. . .”, saktësisht në Qendrën Tregtare “V..”, me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme të pasurisë së huaj për vete, i’a merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarës “V..” në Gj., në atë mënyrë që i pandehuri derisa ishte duke kaluar në afërsi të qendrës së lartcekur, fillimisht afrohet tek produktet që ishin në afërsi të derës së depos, dhe aty vjedh një komplet shmand, një komplet kos 1 kg dhe një komplet kos te vegjël, e më pas largohet pa u vërejtur nga askush, ku pas shikimit të kamerave të sigurisë, është vërejtur se i pandehuri kishte marrë produktet në fjalë, me ç’rast të dëmtuarës “V..”, i shkakton dëm në vlerë prej rreth 41.40 euro.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 313 par. 2 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit **4,17, 38,46,47,48,49 ,69, 70** të KPRK-ës, dhe nenit 313par.231 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **90 (nëntëdhjetë) ditësh**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara “V..” në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II nr. 04/22 të dt.31.01.2022, e ka akuzuar të akuzuarin N.I. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 313 par.2 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.06.07.2022, përfaqësuesi i PTH-DP në Gjakovë, Prokurori shtetit Q.Xh., lexon aktakuzën PP/II nr. 04/22 të dt.31.01.2022, me ç’rast deklaron se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari N.I., në shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë e procedurës jam përdorur për veprën e kryer për shkak të gjendjes së dobët ekonomike pasi jam i pa punë dhe mbajtës i vetëm i familjes 8 anëtarësh, ku asnjëri nga ata nuk janë të punësuar, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, kërkojë falje për demin e shkaktuar të dëmtuarës, andaj i propozoi gjykatës që të marrë parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, kërkim falje nga e dëmtuara, gjendjen e dobët ekonomike –shfrytëzues i ndihmave sociale si dhe faktin se me parë nuk kam ra ndesh me ligjin, të me shqiptojë një dënim me të butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari Prokurori i shtetit Qazim Xharra, deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu i akuzuari N.I., pasi që të njëjtin pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion pas sqarimeve të mjaftueshme edhe nga ana e gjykatës, dhe se ky pranimi i fajësisë ka mbështetje të plote edhe në provat që e mbështesin aktakuzën, andaj gjykatës i propozoi që të aprovojë pranimin e fajësisë dhe të akuzuarit të shqiptojë një dënim konform ligjit duke marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese e po që se gjenë edhe ato renduese dhe njëherë të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari N.I.: **-me datë 07.12.2021 rreth orës 10:48 min, në Gjakovë në rr., saktësisht në Qendrën Tregtare “V..”, me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme të pasurisë së huaj për vetë, i’a merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarës “V..” në Gjakovë, në atë mënyrë që i pandehuri derisa ishte duke kaluar në afërsi të qendrës së lartcekur, fillimisht afrohet tek produktet që ishin në afërsi të derës së depos, dhe aty vjedh një komplet shmand, një komplet kos 1 kg dhe një komplet kos të vegjël, e më pas largohet pa u vërejtur nga askush, ku pas shikimit të kamerave të sigurisë, është vërejtur se i pandehuri kishte marrë produktet në fjalë, me ç’rast të dëmtuarës “V..”, i shkaktonte dëm në vlerë prej rreth 41.40 euro. **-me çka ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 313 par. 2 të KPRK-së.****

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me

nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana renduese gjykata konstatoi faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale si në dispozitiv të aktakuzës, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se i njëjti është baba i 6 fëmijëve ,gjendjen e dobët ekonomike –shfrytëzues i ndihmave sociale pendimin e shprehur në gjykatë për veprën e kryer ,i pa punë dhe mbajtës i vetëm i familjes 8 anëtarësh ,premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet , kërkim falja për demin e shkaktuar të dëmtuarës, , të cilat rrethana ndikuan që gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me shpresë dhe bindje se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij ,do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale , ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien ne barrën e mjeteve buxhetore, gjykata e morri ne mbështetje te nenit 453/4 te KPP-ës ,pasi qe i akuzuari është shfrytëzues i ndihmave sociale e detyrimi qe ti paguajnë shpenzimet procedurale do te rrezikonte gjendjen materiale te akuzuarit ose të personave që ai detyrohet ti mbështes materialisht.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.34/22 më datë 06.07.2022.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykatë.